

TELEKOM ALBANIA Sh.a.

**PASQYRAT FINANCIARE SIPAS STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT
FINANCIAR PER VITIN USHTRIMOR TE MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017**

Tabela e përmbajtjes

Raporti i audituesit të pavarur.....	i
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	1
Pasqyra e pozicionit financiar.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	
1. Historiku i shoqërisë.....	6
2. Përmbledhje e politikave kontabël.....	6
3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël.....	14
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara.....	15
5. Standarde të reja.....	15
6. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	18
7. Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit.....	21
8. Kosto e shërbimeve të realizuara.....	21
9. Shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative.....	21
10. Shpenzime tatim fitimi.....	22
11. Aktive afatgjata materiale.....	24
12. Aktivët afatgjata jomateriale.....	26
13. Inventari.....	26
14. Llogaritë e arkëtueshme.....	27
15. Aktive të tjera.....	28
16. Mjete monetare.....	29
17. Kapitali aksioner.....	30
18. Rezervat.....	30
19. Fitimi për aksion.....	30
20. Të ardhura e papërfituara.....	30
21. Provigjonet.....	31
22. Llogaritë e pagueshme.....	32
23. Shpenzime të përlllogaritura dhe detyrime të tjera.....	32
24. Instrumentet financiare.....	33
25. Vlera e drejtë.....	34
26. Palët e lidhura.....	35
27. Pensionet e stafit dhe shpërblimet pas daljes në pension.....	38
28. Angazhime dhe aktive/detyrime të kushtëzuara.....	39
29. Ngjarje pas datës së raportimit.....	42



Raporti i audituesit të pavarur

Drejtuar Aksionarëve të Telekom Albania sh.a.

Opinionit ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Telekom Albania sh.a. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2017, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017;
- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për vijueshmërinë e aktivitetit, duke prezantuar, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit përveç kur drejtimi synon ta likujdijë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri

T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk garanton që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një gabim material, në rast se ekziston. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional përgjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshëm lidhur me auditimin, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Japim përfundimin mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të gjatë auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë bazuar në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
18 qershor 2018
Tiranë, Shqipëri

Loreta Peci
Auditues ligjor

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
 (në mijë Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat operative			
Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit	7	8,989,132	10,407,882
Të ardhura nga shitja e aparateve dhe aksesorëve	7	136,831	198,792
Totali i të ardhurave operative		9,125,963	10,606,674
Kosto e shitjeve dhe shërbimeve të ofruara			
Kosto e shërbimeve të realizuara	8	(9,755,164)	(7,403,877)
Kosto e shitjes së aparateve dhe aksesorëve		(186,102)	(233,513)
Totali i kostos së shitjeve dhe shërbimeve		(9,941,266)	(7,637,390)
Fitimi Bruto		(815,303)	2,969,284
Shpenzimet e përgjithshme, të shitjes dhe administrative	9	(3,694,283)	(3,434,237)
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	14	(18,964)	(10,901)
(Shpenzime) / të ardhura të tjera		(473)	2,523
Fitimi operativ neto		(4,529,023)	(473,331)
Të ardhurat dhe shpenzime financiare			
Të ardhura nga interesat		610,982	1,686,400
Komisione dhe tarifa të tjera bankare		(32,504)	(26,723)
Humbje neto nga kursi i këmbimit		(899,895)	(1,030,520)
Totali i të ardhurave financiare, neto		(321,417)	629,157
Fitimi para tatimit		(4,850,440)	155,826
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	10	(550,641)	(133,762)
Fitimi për vitin financiar		(5,401,081)	22,064
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		(5,401,081)	22,064
Fitimi bazë dhe i pakësuar për aksion (Lek)	19	(6,637)	27

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 41, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.


TELEKOM ALBANIA Sh.a.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
(në mijë Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivët			
Aktive afatgjata materiale	11	5,657,075	9,390,761
Aktive afatgjata jomateriale	12	3,993,044	4,411,081
Aktiv tatimor i shtyrë	10	0	550,641
Llogari të arkëtueshme	14	0	10,664
Aktive financiare të mbajtura deri në maturitet	26	2,013,635	0
Aktive të tjera afatgjata	15	174,196	181,985
Totali i aktiveve afatgjata		11,837,950	14,545,132
Inventari	13	352,556	388,431
Llogari të arkëtueshme	14	2,347,101	2,115,102
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	26	694,153	5,213,314
Aktive financiare të mbajtura deri në maturitet	26	15,539,184	23,353,986
Tatim fitimi i arkëtueshëm	10	799,691	799,691
Aktive të tjera afatshkurtra	15	880,053	957,018
Mjete monetare	16	43,336,756	38,955,953
Totali i aktiveve afatshkurtra		63,949,494	71,783,495
Totali i aktiveve		75,787,444	86,328,627
Kapitali			
Kapitali aksionar	17	813,822	813,822
Primi i aksioneve	17	15,777	14,641
Rezerva	18	23,677,017	23,677,017
Fitimi i pashpërndarë		44,237,462	49,638,543
Totali kapitalit		68,744,078	74,144,023
Detyrime			
Të ardhura të shtyra	20	237,372	270,736
Qera financiare		4,374	9,356
Provizjone	21	175,559	149,710
Totali i detyrimeve afatgjata		417,305	429,802
Llogaritë e pagueshme	22	4,956,203	6,218,117
Detyrime ndaj palëve të lidhura	26	1,068,338	4,643,628
Të ardhura të shtyra	20	210,115	473,790
Qera financiare		5,198	5,113
Detyrime të tjera afatshkurtra	23	352,174	371,155
Provizjone	21	34,033	42,999
Totali i detyrimeve afatshkurtra		6,626,061	11,754,802
Totali i detyrimeve		7,043,366	12,184,604
Totali kapitalit dhe detyrimeve		75,787,444	86,328,627

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 41, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i Telekom Albania sh.a. më dhe janë firmosur në emër të tij më 11/11/2018 nga:


Dimitris Blatsios
Drejtor Ekzekutiv
TELEKOM ALBANIA SH.A.
Rruga e Llogaritëve, Tiranë, Të 04 2275000
NPT 061514094W


Dimitrios Paschos
Drejtor Financiar
TELEKOM ALBANIA SH.A.
Rruga e Llogaritëve, Tiranë, Të 04 2275000
NPT 061514094W

TELEKOM ALBANIA Sh.a.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
(në mijë Lekë)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

(në mijë Lekë)

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	813,822	14,086	23,677,017	49,616,479	74,121,404
Fitimi i vitit	-	-	-	22,064	22,064
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	22,064	22,064
Opsione për aksione	-	555	-	-	555
Gjendja më 31 dhjetor 2016	813,822	14,641	23,677,017	49,638,543	74,144,023
Gjendja më 1 janar 2017	813,822	14,641	23,677,017	49,638,543	74,144,023
Humbja e vitit	-	-	-	(5,401,081)	(5,401,081)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(5,401,081)	(5,401,081)
Opsione për aksione	-	1,136	-	-	1,136
Gjendja më 31 dhjetor 2017	813,822	15,777	23,677,017	44,237,462	68,744,078

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 41, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E LËVIZJEVE TË MJETEVE MONETARE
 (në mijë Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset monetare nga veprimtaria e shfrytëzimit (Humbja)/fitimi neto para tatimit		(4,850,440)	155,826
<i>Rregullime:</i>			
Amortizimi	11,12	2,505,793	2,677,474
Zhvlerësim i aktiveve	11,12	2,803,282	-
Fitimi nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		(2,400)	(2,123)
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	14	(20,903)	(17,741)
Kthimi i humbjeve nga zhvlerësimi (borxhet e mbledhura)		(1,939)	(6,640)
Te ardhura financiare neto		(573,492)	(1,666,516)
Diferencat e përealizuara nga kursi i këmbimit		1,461,980	1,001,440
Pagesat e bazuara në aksione të shlyeshme nëpërmjet kapitalit		1,136	555
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		1,323,017	2,142,275
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme		(202,060)	(750,665)
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura		2,605,570	632,802
Ndryshimi në inventar		35,876	40,450
Ndryshimi në aktivet e tjera afatshkurtra		2,097,293	73,713
Ndryshimi në detyrimet ndaj palëve të lidhura		(3,651,328)	(816,667)
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme		(369,993)	2,405,013
Ndryshimi në të ardhurat e shtyra		(297,039)	(101,993)
Ndryshimi në provigjone dhe detyrime të tjera afatshkurtra		25,037	(8,847)
Mjete monetare të krijuara nga veprimtaria e shfrytëzimit		1,566,373	3,616,081
Pagesat për tatimin mbi fitimin		0	(3,016)
Interesat e paguara		(34,183)	(18,057)
Paraja neto nga veprimtaria e shfrytëzimit		1,532,190	3,595,008
Flukse monetare nga veprimtaria e investimit			
Blerjet e aktiveve afatgjata	11,12	(2,113,920)	(2,232,750)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		3,558	24,313
Interesa të arkëtuara		881,136	2,199,967
Investime në aktive financiare të mbajtura deri në maturitet	26	(17,549,550)	(23,381,910)
Arkëtime nga aktivet financiare	26	22,781,245	57,092,973
Paraja (përdorur në)/neto nga veprimtaria e investimit		4,002,469	33,702,593
Flukse monetare nga aktivitetet financiare			
Dividente të paguar		0	(815)
Paraja (përdorur në)/neto nga aktivitetet financiare		0	(815)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit		(1,153,856)	(558,355)
Rritja neto në mjetet monetare		4,380,803	36,738,431
Mjete monetare më 1 janar		38,955,953	2,217,522
Mjete monetare më 31 dhjetor	17	43,336,756	38,955,953

Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 41, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. Historiku i shoqërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR) për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2017 për Telekom Albania Sh.a. (më poshtë referuar "Telekom Albania" ose "Shoqëria"), e njohur më parë si Albanian Mobile Communications Sh.a., u themelua si një shoqëri me kapital aksionar më 22 nëntor 1995 dhe është e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në bazë të vendimit nr. 12910 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit të subjektit J61814094W.

99.76% e aksioneve të kapitalit të shoqërisë zotërohet nga Cosmote Mobile Telecommunications S.A. Pronësia e mbetur prej 0.24% i përket aksionarëve jo-kontrollues. Shoqëria mëmë e gjithë grupit është Deutsche Telecom AG ("DTAG"), Bon, Gjermani.

Aktiviteti kryesor: Shoqëria është një operator telekomunikimi përqendruar në ofrimin e telefonisë celulare (lëvizëse). Që prej vitit 2003, Telekom Albania fitoi një licencë për të ofruar shërbime të transmetimit të të dhënave për 5 vite, ndërkohë që prej datës 26 dhjetor 2008, Shoqëria zotëron "Autorizimin e Përgjithshëm" për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, i cili përfshin edhe shërbimet e transmetimit të të dhënave dhe si rrjedhim, rinovimi i licencës së vjetër për transmetimin e të dhënave nuk është më i nevojshëm. Gjatë vitit 2011, Telekom Albania u pajis me licencën 3G për të operuar në rrjetin 2100 GSM. Gjatë muajit Janar 2015, shoqëria rinovoi licencën GSM për një periudhë 15 vjeçare. Gjatë muajit Mars 2015, shoqëria fitoi një tender publik të organizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ("AKEP") për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX për një periudhë 15 vjeçare. Gjatë muajit Prill 2015, shoqëria fitoi tenderin publik të organizuar nga AKEP për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 2500-2690 MHz. Në janar të vitit 2018, shoqëria ka blerë nga shoqëria Plus spektrin e frekuencave (8 MHz) në 900 MHz, (9 MHz) në 1800 MHz dhe (10 MHz) në 2100 MHz, e cila është e ndarë 50% / 50% midis Telekom Albania dhe Vodafone Albania. Ky spektër shtesë pritet të rrisë kapacitetin dhe cilësinë e transmetimit të Shoqërisë.

Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e biznesit: Adresa e regjistruar dhe vendndodhja kryesore e shoqërisë është Rruga "Gjergj Legisi" Laprakë, Tiranë, Shqipëri.

Monedha e raportimit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), të rrumbullakosura në shumën më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

2. Përmbledhje e politikave kontabël

(a) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimet përkatëse të publikuara nga Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar (KIRFN), në përputhje me Ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Gjithashtu kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Zonat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 3.

(b) Monedha funksionale dhe ajo raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lekë shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilën Shoqëria kryen veprimtarinë e saj.

Transaksionet dhe balancat. Aktivitetet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit të këmbimit në fuqi në fundin përkatës të periudhës raportuese. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

përkthimi i mjeteve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike në kurset e këmbimit në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje si të ardhura ose shpenzime financiare. Përkthimi në fund të vitit nuk aplikohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike.

Zërat jo monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj, duke përfshirë investimet e kapitalit, janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e regjistrimit kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes në vlerën e drejtë.

c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të shoqërisë gjatë vitit 2017 dhe 2016, përbëhen nga instrumente financiarë jo-derivative: hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare (përfshirë depozitat e mbajtura deri në maturitet), aktive financiare të mbajtura deri në maturitet dhe llogaritë e pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumente financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes apo të disponueshme për shitje në datën e raportimit.

(i) Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare llogariten në datën e tregimit, data kur shoqëria angazhohet të blejë apo shesë aktivin. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Kostot e transaksionit përfshihen për instrumentet që nuk klasifikohen si të mbajtur me vlerë të drejtë.

(ii) Matjet e mëpasshme

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre. Në mjetet monetare dhe të ngjashme përfshihen balanca e mjeteve monetare në arkë, llogaritë bankare rrjedhëse dhe depozitat bankare afatshkurtër. Për qëllim të pasqyrës së lëvizjes së flukseve monetare, në mjetet monetare dhe të ngjashme përfshihen depozita të pakushtëzuara me afat maturimi më pak se tre muaj nga data e fillimit. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre maten me vlerë të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme maten me vlerë të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme me afat të shkurtër nuk aktualizohen.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet. Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet përfshijnë aktivet financiare të kuotuar jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse që shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturitet. Drejtimi përcakton klasifikimin e letrave me vlerë të investimeve të mbajtura deri në maturitet në njohjen e tyre fillestare dhe rëzimin përshatësor të klasifikimit në fund të çdo periudhe raportuese. Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, neto nga ndonjë dispozitë për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Llogaritë e Pagueshme. Llogaritë e pagueshme maten me kosto të amortizuar. Fitimet ose humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe pasivet financiare të mësipërme regjistrohen ose zhvlerësohen, si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

(iii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar në qoftë se ka një evidence objektive që një ose më shumë ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të çmuara për këtë aktiv.

Vështirësitë financiare të debitorëve, probabiliteti i falimentimit apo riorganizimi financiar i debitorit si dhe mashtimet e gabimet në pagesa, janë disa shembuj treguesish për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Aktivet financiare testohen për zhvlerësim individualisht. Aktivet financiare që mbeten, testohen për zhvlerësim në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

Humbja nga zhvlerësimi që lidhet me aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Vlera kontabël neto e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes dhe vlera e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të përlllogariten mbi vlerën e mbetur të zvogëluar bazuar në normën fillestare të interesit efektiv. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me llogaritë e zbritjes, çregjistrohen kur nuk ka perspektive realiste për rikuperim në të ardhmen.

Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjeve nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi i njohur në periudhat e mëparshme do të anulohet nëpërmjet rregullimit të llogarisë së zbritjes. Në rast se anulimi rikthehet, shuma njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(iv) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të shoqërisë ndaj flukseve monetare shuhet, ose kur aktivi financiar i transferohet palëve të tjera pa mbajtur kontrollin apo rreziqet dhe përfitimet prej aktivitetit financiar. Detyrimet financiare të shoqërisë çregjistrohen kur përfundojnë, shlyhen apo anulohen.

(v) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në bilanc, vetëm në qoftë se ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe ekziston qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, ose të lirohet aktivi dhe shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagimi (iii) në rast të falimentimit.

(vi) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare, të llogarive të arkëtueshme dhe të drejtave të tjera, të llogarive të pagueshme dhe të detyrimeve të tjera, është afërsisht e barabartë me vlerën e mbartur të tyre, si pasojë e maturitetit afatshkurtër.

Vlera e drejtë e aktiveve të mbajtura deri në maturim është përafërsisht e barabartë me vlerën e tyre të mbartur sepse huatë janë me interes të luhatshëm i cili reflekton ndryshimet në kushtet e tregut.

(d) Aktivitetet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe Matja

Aktivitetet afatgjata materiale maten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostot e çmontimit dhe heqjes së një zëri nga aktivitetet afatgjata materiale i shtohen kostos së zërit në rastet kur zëri është blerë ose nëse zëri është përdorur gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të tjera nga ato për të prodhuar inventarët. Ndryshimet në vlerësimin e detyrimit (për daljen jashtë përdorimit të aktivitetit) rezultojnë nga ndryshime në kohën ose shumën e parashikuar të rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer detyrimin dhe nga ndryshime në normën e skontimit. Në këto raste kostoja e aktivitetit përkatës rregullohet nëse aktivi matet duke përdorur modelin e koston ose suficiti i vlerësimit rregullohet nëse aktivi matet duke përdorur modelin e rivlerësimit. Kostoja e stacioneve bazë të shoqërisë përfshin gjithashtu një vlerësim të kostove të çmontimit dhe heqjes dhe rregullimit të vendeve në të cilat ato janë të vendosura.

Në rast blerje softweri i cili është pjesë përbërëse e funksionalitetit të pajisjeve, software do të kapitalizohet si pjesë e asaj pajisjeje.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si elemente të ndarë (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivit material afatgjatë kapitalizohen kur, ka mundësi që shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga ky aktiv dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e elementëve që zëvendësohen, çregjistrohet. Të gjithë kostot e tjera njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse siç ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi regjistrohet duke u bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Jeta e dobishme e aktiveve për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Ndërtesa (aktive administrative)	20 vjet
• Ndërtesa të rrjetit	10 vjet
• Instalimet dhe sistemet e telekomunikacionit	5-10 vjet
• Kompjuterat (aktive administrative)	3 vjet
• Pajisjet e transportit (aktive administrative)	6-7 vjet
• Mobilie e orëdi (aktive administrative)	5 vjet

Jeta e dobishme, metodat e amortizimit dhe vlerat e rikuperueshme, kur janë të rëndësishme, të aktiveve afatgjata materiale janë rivlerësuar në çdo datë raportimi përmes një komisioni të përbërë nga personel teknik.

Gjatë vitit 2017, shoqëria ka rishikuar jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, të cilat mbeten të pandryshuara në krahasim me periudhat e mëparshme.

(iv) Çregjistrimi

Aktivët afatgjata materiale çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nga shitja apo përdorimi i tyre, nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit apo shitja e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël neto dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

(e) Aktivët afatgjatë jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë licencat si LTE, 3G, 2G dhe programe kompjuterike.

(i) Njohja dhe matja

Licencat e blera nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi, në rast se ka të tilla.

(ii) Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme për aktivin në fjalë. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në fitim/humbje kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit duke filluar nga data kur aktiv i ka qenë i disponueshëm për t'u përdorur. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjatë jomateriale për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Licenca	3-7 vjet
• Licenca 3G	15 vjet
• Licenca 4G	15 vjet
• Programet kompjuterike	3 vjet

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

(f) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se ekzistojnë këta tregues, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet afatgjata jomateriale që ende nuk janë të disponueshme për t'u përdorur, vlera e rikuperueshme përcaktohet në çdo datë raportimi.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël neto e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi regjistrohen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe asaj të drejtë minus kostot e shitjes. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara skontojnë duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet kur ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe kanë ndryshuar supozimet e përdorura në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme të aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pasi të ishte zbritur zhvlerësimi apo amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

(g) Inventari

Inventarët që përfshijnë kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesoret përkatës dhe kancelari e pajisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me më të voglën midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i çmuar në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe realizimit të shitjes. Kosto e inventarëve llogaritet mbi bazën e metodës mesatare dhe përfshin kostot e kryera për blerjen dhe sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Pajisjet dhe aksesoret që u jepen klientëve falas në këmbim të abonimeve të reja regjistrohen në shpenzime shitjeje dhe administrative në fitim/humbje kur ato ndodhin.

(h) Dividendët

Dividendët njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës së raportimit dhe parapasqyrat financiare të autorizohen për lëshim, shpalosen në shënimin e ngjarjeve të mëvonshme. Raportet statutorë të kontabilitetit të shoqërisë të përgatitura në përputhje me SNRF shërbejnë si bazë për shpërndarjen e fitimit dhe shpërndarjet e tjera.

(i) Përfitimet e punonjësve

(i) Pensionet e detyrueshme

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, shoqëria kryen pagesa kontributesh për llogari të saj dhe të punonjësve për të kontribuar në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e kryera për llogari të shoqërisë në këtë skemë me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Transaksionet e pagesave bazuar në aksione

Shoqëria administron një plan kompensimi të bazuar në aksione (i shlyer në mjete monetare) dhe kompensim në aksione (i shlyer në kapital) për drejtuesit. Vlera e drejtë e opsioneve të dhënë për punonjësit njihet si një shpenzim për punonjësit dhe në të njëjtën kohë rrit primet e aksionit gjatë periudhës që punonjësi ka të drejtë të pakundërshtueshme kundrejt opsioneve. Shuma totale që duhet të njihet gjatë periudhës së kushtëzimit përcaktohet duke iu referuar vlerës së drejtë të opsioneve ose aksioneve të përcaktuara në datën e dhënies, duke përjashtuar ndikimin e kushteve të tjera jo të tregut (për shembull, objektivat e rritjes së fitimit dhe shitjes). Arritja e shërbimeve dhe kushteve të kushtëzuara jo të tregut përfshihen në supozimet mbi numrin e opsioneve që pritet të bëhen të ushtrueshme ose numrit të aksioneve që punonjësi do të marrë në fund.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

Ky vlerësim rishikohet në çdo datë të bilancit dhe diferenca njihet ose kreditohet në fitim ose humbje, me një rregullim në kapitali. Nuk bëhen ndryshime kur niveli i pritshëm ose aktual i dhënies së shpërblimeve ndryshon nga vlerësimi fillestar për shkak të mos arritjes së kushteve të performancës së tregut, p.sh. kthimin e duhur të aksionarëve ose çmimin e aksionit. Të ardhurat e marra në ushtrimin e opsioneve të netuara nga çdo kosto të transaksioni kreditohen në kapitalin aksionar (vlera nominale) dhe në premiumin e aksionit. Çmimet e anuluar konsiderohen të jenë shpallur fituese pas anulimit. Çdo shpenzim i paamortizuar i lidhur me shpërblime të tilla i ngarkohet menjëherë fitimit ose humbjes.

(j) Provigjonet

Provigjonet për detyrimet janë detyrime jofinanciare me kohë dhe shuma të pasigurta. Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si pasojë e një ngjarjeje të shkuar dhe për të shlyer detyrimin do të kërkohej një përdorim i burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin për të cilin mund të kryhet një vlerësim i besueshëm. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohej për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim interesi. Taksat dhe detyrimet, të tilla si tatimi përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifatat rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja që shkakton pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

(j) Qiratë

Kur Shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga qiradhënësi tek Shoqëria, pagesat e përgjithshme të qirasë ngarkohen në fitim ose humbje për vitin në bazë lineare duke përdorur afatin e qirasë. Afati i qirasë është periudha e pa-anullueshme për të cilën qiramarrësi ka vendosur në kontratë për dhënie me qira të asetit së bashku me çdo kusht tjetër për të cilin qiramarrësi ka mundësi të vazhdojë ta jap me qira aktivin, me ose pa pagesë të mëtejshme, kur në fillim të kontratës është e sigurt që qiramarrësi do të ushtrojë kontratën.

Kur Shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje e cila ka transferuar në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbi pronësinë shoqërisë, asetet e dhëna me qira kapitalizohen në aktive afatgjata materiale në fillim të qirasë me vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë të aktivit të dhënë me qira dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Çdo pagesë e qirasë ndahet midis detyrimeve dhe pagesave të financimit në mënyrë që të arrihet një normë konstante në balancën financiare. Detyrimet përkatëse të qirasë, neto nga pagesat e ardhshme të financimit, përfshihen në huamarrje. Kostoja e interesit ngarkohet në fitim ose humbje gjatë periudhës së qerasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Asetet e blera në bazë të qirasë financiare zhvlerësohen gjatë jetës së tyre të dobishme ose me afatin më të shkurtër të qirasë, nëse Shoqëria nuk është e sigurt se do të marrë pronësinë në fund të afatit të qirasë.

Për qira të pagueshme sipas qirasë operative referojuni shënimit 2 m (i).

(l) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumat e arkëtueshme për shërbimet dhe mallrat e furnizuara, të deklaruar neto nga zbritjet, kthimet dhe tatimet mbi vlerën e shtuar. Shoqëria njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kur janë përmbushur kriteret specifike për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë, siç përshkruhet më poshtë. Kur vlera e drejtë e mallrave të marra në një transaksion shkëmbimi nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimit të dhënë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

Shërbimet

Shitjet e shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si pjesë e shërbimeve totale që duhet të ofrohen.

Të ardhurat nga shërbimet përbëhen nga ato në vijim:

(i) Tarifat mujore

Te ardhurat e lidhura me tarifat mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet dhe kur përcaktohet në kontratën me klientët.

(ii) Tarifat e përdorimit dhe tarifat për shërbimet shtesë

Tarifat e thirrjeve konsistojnë në tarifa për kohën e bisedës dhe trafikun e gjeneruar nga telefonuesi, destinacionin e telefonatës dhe shërbimin e përdorur. Tarifat e përdorimit bazohen në trafikun e gjeneruar, përdorimin e kohës së bisedës ose volumin e transmetimit të të dhënave për shërbimet shtesë, si mesazhet e shkurtra, përdorimin e internetit dhe shërbimin e të dhënave.

Të ardhurat nga tarifat e përdorimit dhe shërbimet shtesë njihen në periudhën kur këto shërbime u sigurohen abonentëve. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimeve, në datën e fundit të çdo muaji vlerësohen bazuar në trafikun e gjeneruar dhe regjistrohen në fund të çdo muaji.

Të ardhurat nga shitja e kartave telefonike me parapagim dhe kohës së parapaguar, të përfshira në paketën e shoqërisë për shërbimet e parapaguara, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

(iii) Tarifat roaming

Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, operatorët e tjerë të rrjeteve celulare faturojnë shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur janë kryer shërbimet.

(iv) Tarifat e interkonjeksionit

Trafiku i gjeneruar midis dy shoqërive të telekomunikacionit menaxhohet përmes procesit të interkonjeksionit. Shoqëria e telekomunikacionit e abonentit që kryen një thirrje pëson në të njëjtën kohë një shpenzim ndërsa shoqëria ku telefonata përfundon realizon një të ardhur duke faturuar shoqërinë e telekomunikacionit të abonentit thirrës.

Të ardhurat e interkonjeksionit realizohen nga telefonatat e përfunduara në rrjetin e Telekom Albania ndërkohë që janë gjeneruar nga rrjete të operatorëve fiks apo lëvizës vendas apo të huaj.

Të gjithë regjistrimet që kanë Telekom Albania si numër thirrës dhe një abonent të një shoqërie tjetër si numër të thirrur, krijojnë një shpenzim për Telekom Albania. Kostot e interkonjeksionit burojnë nga të gjithë thirrjet që krijohen në rrjetin e shoqërisë dhe përfundojnë në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare të huaja dhe vendase, duke përdorur rrjetet e shoqërisë. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në fitim/humbje në momentin kur thirrja mbërrin në rrjetin e shoqërisë (në rrjetin e operatorëve të tjerë).

(v) Të drejtat e pamohueshme të përdorimit

Shoqëria gjithashtu jep të drejta të përdorimit të rrjetit të telekomunikacionit dhe fibrave optike për të cilat të ardhurat njihen në bazë të metodës linere (shënimi 20).

Mallrat

Të ardhurat nga shitja e aparateve celulare dhe aksesoreve, pasi zbriten zbritjet, njihen me livrimin e tyre kur titulli dhe rreziqet e shpërblimit e pronësisë i kalojnë klientit.

Të ardhurat nga shitja e aparateve dhe aksesoreve, neto ndaj zbritjeve të lejuara, njihen në momentin e dorëzimit të mallrave kur titulli dhe rreziqet dhe përfitimet e pronësisë kalojnë tek klienti.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

Në disa raste, marrëveshjet e abonimit të klientëve përfshijnë shitje pajisjesh dhe shitje shërbimesh. Shoqëria e konsideron shitjen e pajisjeve dhe të shërbimeve si të ndara nga pikëpamja e procesit të të ardhurave dhe i klasifikon të ardhurat për çdo shpërndarje duke përdorur metodën e mbetur për çdo element. Këto njësi identifikohen dhe ndahen, duke qenë se kanë vlerë në mënyrë të ndarë dhe shiten bashkërisht por gjithmonë të ndara. Në këtë mënyrë, shoqëria njeh të ardhurat për këta elementë duke përdorur metodën e mbetur sipas të cilës shumat e konsideratës së shpërndarë ndaj elementëve të marrëveshjes barazon konsideratën totale pas vlerës së drejtë të elementëve të pashpërndarë.

(m) Shpenzimet

(i) Shpenzimet e qirasë

Shoqëria merr linja me qira kryesisht nga shoqëri lokale telekomunikacioni për të lidhur rrjetin e saj me rrjetin e linjave fikse të palëve të treta.

Shpenzimet e qirave operative njihen në fitim/humbje në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Përfitimet e marra njihen si pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë përgjatë afatit të qirasë.

(ii) Shpenzimet e reklamës

Të gjitha kostot e marketingut njihen si shpenzime kur ndodhin dhe përfshihen në shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative në fitim/humbje.

(iii) Subvencione dhe komisione

Subvencionet për klientët e rinj ose ekzistues nëpërmjet distributorëve ose dyqaneve njihen në fitim/humbje kur ato ndodhin. Komisionet varen nga e ardhura që sjell abonenti ose koha që abonenti qëndron në rrjet. Ato llogariten dhe njihen në fitim/ humbje në baza mujore.

(n) Të ardhura financiare

Të ardhurat nga interesat njihen në fitim/humbje në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara, duke përdorur normën efektive të aktivitetit përkatës.

(o) Tatimi mbi fitimin

Tatimet mbi fitimin janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që konsiderohet si i tillë në fund të periudhës raportuese. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim/humbjen e vitit, përveç rastit kur njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital për shkak se ka të bëjë me transaksionet që janë të njohura në të njëjtën ose një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i parashikuar për t'u paguar ose rimbursuar nga organet tatimore, i përlogaritur mbi fitimin e tatueshëm për periudhën aktuale ose ato paraprake. Fitimet ose humbjet e tatueshme janë të bazuara në parashikime nëse pasqyrat financiare janë autorizuar përpara plotësimit të deklaratave përkatëse të tatim-fitimit. Tatimet e tjera mbi të ardhurat janë të regjistruara në kuadër të shpenzimeve operative.

Në përputhje me përjashtimin në njohjen fillestare, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për ato diferenca të përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose detyrimi në një transaksion tjetër përveçse një kombinimi biznesi, nëse transaksioni nuk ndikon as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

(p) Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar e produktit që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në fillim të (a) mbledhjes së të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve të klientët. TVSH-ja e inputeve në përgjithësi mund të jetë e arkëtueshme kundrejt TVSH-së së prodhimit pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2.Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdimi)

TVSH-ja e lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpalloset veçmas si një aktiv dhe pasiv. Kur është krijuar provigjion për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohët për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

(q) Parapagimet

Parapagimet njihen me kosto minus provigjionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagesën pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë do të klasifikohet si jo-afatshkurtër pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aseteve transferohen në vlerën kontabël të aktivit sapo Shoqëria ka marrë kontrollin e aktivit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në Shoqëri. Pagesat paraprake të tjera hiqen nga pasqyra e fitimit dhe humbjes kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se asetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me një parapagim nuk do të merren, vlera bartëse e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

(r) Fitimi për aksion

Fitimet bazë dhe ato të pakësuara për aksion llogariten duke pjesëtuar fitimin neto me mesataren e ponderuar të numrit të aksioneve gjatë çdo viti.

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur.

Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Parimi i vijueshmërisë. Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare në bazë të parimit të vijueshmërisë. Gjatë marrjes në konsideratë të këtij gjykimi, drejtimi morri parasysh pozicionin financiar të Shoqërisë, objektivat e tanishme, pozitën e fortë të likuiditetit dhe pritshmëritë e ardhshme për përfitueshmërinë e operacioneve, aksesin në burimet financiare si dhe ka analizuar ndikimin e situatës në tregun shqiptar të telekomunikacionit në operacionet e Shoqërisë. Pavarësisht rezultateve negative të vitit të tanishëm, bazuar në strategjinë dhe planet afatmesme të biznesit, drejtimi i shoqërisë beson se do të rikuperojë përfitueshmërinë brenda disa viteve të ardhshme.

Njohja e të ardhurës së tatimit të shtyrë. Shoqëria nuk ka njohur aktivet tatimore të shtyra të të ardhurave që përfaqësojnë tatimet në të ardhura të rikuperueshme nëpërmjet zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme të regjistruara më parë në pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivët e tatimit mbi fitimin e shtyrë regjistrohen në masën që realizimi i përfitimit tatimor është i mundshëm. Kjo përfshin diferencën e përkohshme që pritet të ndryshojë në të ardhmen dhe disponueshmërinë e fitimit të mjaftueshëm të ardhshëm, ndaj të cilit mund të shfrytëzohen zbritjet. Fitimet e tatueshme në të ardhmen dhe shuma e përfitimeve tatimore që janë të mundshme në të ardhmen bazohen në planin afatmesëm të biznesit të përgatitur nga drejtimi nga rezultatet e ekstrapoluara më pas. Plan i biznesit bazohet në pritshmëritë e drejtimit që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Bazuar në këto plane, drejtimi i Shoqërisë ka përcaktuar që aktiv i tatimit mbi të ardhurat duhet të regjistrohet për të pasqyruar pritshmëritë aktuale të përfshira në planin e biznesit të Shoqërisë, i cili pasqyron situatën aktuale të tregut të telekomunikacionit në Shqipëri dhe perspektivat e ardhshme.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Jeta e dobishme e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Vlerësimi i jetës së dobishme të zërave të pronës, impianteve dhe pajisjeve është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me pasuri të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në asetet konsumohen kryesisht përmes përdorimit.

Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe tregtare dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në asete. Drejtimi vlerëson jetët e dobishme të mbetura në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që asetet të fitojnë përfitime për shoqërinë. Janë konsideruar faktorët kryesorë në vijim: (a) përdorimi i pritshëm i aktiveve; (b) gjendja fizike e cilia varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Nëse jetët e dobishme të vlerësuara do të ndryshonin për 10% nga vlerësimet e drejtimit, ndikimi në amortizimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 do të ishte rritja / zvogëlimi i saj për 250,579 mijë lekë (2016: 267,746 mijë lekë).

Informacion shtesë për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare është përshkruar në shënimet e mëposhtme:

- Shënim 10 - Tatimet mbi të ardhurat
- Shënim 11 - Zhvlerësimi i aktive afatgjata materiale
- Shënim 14 - Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme
- Shënim 21 - Provigjonet
- Shënim 28 - Angazhimet dhe detyrimet

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi që nga 1 janari 2017, por nuk kanë pasur një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Dhënia e informacioneve shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 (i publikuar më 29 Janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017).
- Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara - Amendimi i SNK 12 (i publikuar më 19 janar 2016 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).
- Ndryshimet në SNRF 12 të përfshira në Përmirësimet Vjetore të SNRF cikli 2014-2016 (i lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).

5. Standarde të reja

Standarde dhe interpretime të caktuara të reja janë publikuar e të cilat janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit të 2017-s ose më vonë dhe të cilat banka nuk i ka zbatuar më herët.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Tiparet kryesore të standardit të ri janë:

• Asetet financiare kërkohen të klasifikohen në tre kategori matëse: ato që duhet të maten më pas me koston e amortizuar, ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

• Klasifikimi për instrumentet e borxhit nxitet nga modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI). Nëse një instrument borxhi mbahet për të mbledhur, ai mund të bartet me kostone amortizuar nëse plotëson edhe kërkesat e SPPI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat e SPPI që mbahen në një portofol ku një njësi ekonomike zotëron të mbledhë flukse monetare të aktiveve dhe shet aktive mund të klasifikohet si FVOCI.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

5. Standarde të reja (vazhdim)

Aktivet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare që janë SPPI duhet të maten në FVPL (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshirë nuk janë më të ndarë nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të SPPI.

- Investimet në instrumentet e kapitalit maten gjithmonë me vlerën e drejtë. Megjithatë, menaxhmenti mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit është mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në fitim ose humbje.

- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një njësi ekonomike do të kërkohej të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë për detyrimet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në të ardhura të tjera përmbledhëse.

- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi - modeli i pritshëm i humbjeve të kreditit (ECL). Ekziston një qasje "tre faze" e cila bazohet në ndryshimin në cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që nga njohja fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë se njësitë ekonomike do të duhet të regjistrojnë një humbje të menjëhershme të barabartë me ECL 12 mujore për njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të dëmtuara nga kredia (ose ECL gjatë jetës për të arkëtueshmet tregtare). Aty ku ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, dëmtimi matet duke përdorur ECL-në e përjetshme sesa ECL 12-mujore. Modeli përfshin thjeshtimet operacionale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare.

- Kërkesat e kontabilitetit të mbrojtjes u ndryshuan për të harmonizuar kontabilitetin më ngushtë me menaxhimin e rrezikut. Standardi ofron njësi ekonomike me një zgjedhje të politikës kontabël ndërmjet zbatimit të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të SNRF 9 dhe vazhdimin të zbatimit të SNK 39 në të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk trajton kontabilizimin për mbrojtje makro. Bazuar në një analizë të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë në 31 Dhjetor 2017 dhe në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë, menaxhmenti i Shoqërisë nuk pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e tij financiare nga adoptimi të standardit të ri më 1 janar 2018. Procesi i vlerësimit të ndikimit është ende në vazhdim.

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët (lëshuar më 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Standardi i ri prezanton parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit. Çdo mall ose shërbim i bundled që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas dhe çdo zbritje ose zbritje me çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Kur konsiderata ndryshon për ndonjë arsye, shuma minimale duhet të njihet në qoftë se ato nuk janë në rrezik të rëndësishëm të ndryshimit kthyes. Shpenzimet e bëra për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur përfitimet e kontratës konsumohen.

Ndryshimet në SNRF 15, Të hyrat nga Kontratat me Konsumatorët (lëshuar më 12 prill 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet nuk ndryshojnë parimet themelore të Standardit, por sqarojnë se si duhet zbatuar këto parime. Amendamentet sqarojnë se si të identifikojnë një detyrim të kryerjes (premtimi për të transferuar një të mirë ose një shërbim për një klient) në një kontratë; si të përcaktohet nëse një shoqëri është një drejtor (ofruesi i një të mirë ose shërbimi) ose një agent (përgjegjës për rregullimin e të mirave ose shërbimeve që duhet të ofrohen); dhe si të përcaktohet nëse të ardhurat nga dhënia e licencës duhet të njihen në një moment ose me kalimin e kohës. Përveç sqarimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë për të zvogëluar koston dhe kompleksitetin për një shoqëri kur ajo së pari zbaton standardin e ri.

Në përputhje me dispozitat e tranzicionit në SNRF 15, shoqëria ka zgjedhur metodën e tranzicionit të thjeshtuar me efektin e kalimit që do të njihet më 1 janar 2018 në pasqyrat financiare për fund vitin 31 dhjetor 2018, i cili do të jetë viti i parë kur Grupi do të zbatojë SNRF 15.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

5. Standarde të reja kontabël (vazhdim)

Shoqëria zbaton SNRF 15 në mënyrë retrospektive vetëm për kontratat që nuk janë plotësuar në datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018). Miratimi i SNRF 15 do të sjellë ndryshime në politikat kontabël dhe rregullimet që do të njihen në pasqyrat financiare. Bazuar në analizën e rrjedhave të të ardhurave të Shoqërisë për vitin embyllur më 31 Dhjetor 2017, kushtet e kontratave individuale dhe në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë, duke pasur parasysh aplikimin e metodës së thjeshtuar të tranzicionit, menaxhimi i shoqërisë është duke pritur një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e tij financiare nga miratimi i standardit të ri më 1 janar 2018. Procesi i tranzicionit është ende në vazhdim. Megjithatë, bazuar në një përlogaritje të përafërt e cila nuk është konfirmuar ende, efekti kumulativ i aplikimit fillimisht të SNRF15 mbi fitimet e pashpërndara në 1 janar 2018 pritet të përafrojë një shumë prej 20,000 mijë Lekë rritjeje të fitimeve të mbajtura të hapura në atë datë.

SNRF 16 "Qiratë" (lëshuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe zbulimin e qirasë. Të gjitha lizingjet rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu marrin financim. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave të qirasë si qera të qirasë ose qiratë financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Lesseesit do të kërkohet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nënligjor është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë veç e veç nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 16 në thelb përcjell kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera lizingu ose qiratë financiare dhe të llogarisë këto dy lloje të qirasë ndryshe. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

KIRFN 22 "Transaksione në valutë të huaj dhe paradhënie paraprake" (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.) Ky interpretim shqyrton mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit gjatë zbatimit të standardit për transaksionet në valutë, SNK 21. Interpretimi zbatohet kur një njësi ekonomike paguan ose ka marrë parapagim paraprakisht për kontratat në valutë të huaj. Interpretimi specifikon që data e transaksionit është data në të cilën njësi ekonomike fillimisht njeh aktivin jo-monetar ose pasivin jomonetar që rezulton nga pagesa ose marrja e shumës paraprake. Nëse ka pagesa të shumëfishta ose pranime paraprakisht, interpretimi kërkon që një njësi ekonomike të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose marrje të konsideratës së parapaguar. Shoqëria po vlerëson ndikimin e interpretimit.

KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat" (lëshuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por jo si të reflektojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes në SNK 12 kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të shqyrtojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në atë metodë më të mirë parashikon zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike duhet të supozojë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre provimeve. Nëse një njësi ekonomike përfundon se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore, duke përdorur ose shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që njësi ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimin kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i një e drejta e autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosmarrëveshjeje nga një autoritet tatimor me një trajtim tatimor, në izolim, nuk ka të ngjarë të përbëjë një ndryshim në fakte

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

5. Standarde të reja kontabël (vazhdim)

dhe rrethana apo informata të reja që ndikojnë në gjykimet dhe vlerësimet e kërkuara nga Interpretimi. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e interpretimit në pasqyrat financiare të saj.

Shpalljet e mëposhtme të reja nuk priten të kenë ndonjë ndikim material mbi Shoqërinë kur të miratohet:

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë lëshimeve të shoqërive që të mbajnë kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese.
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve në mes të një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- Ndryshimet në SNRF 2, Pagesat me bazë aksione (të dhëna më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshimet në SNRF 4 (të publikuara më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësia ekonomike fillimisht zbaton SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Transferet e Pronës së Investimit - Ndryshimet në SNK 40 (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF-ve 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (i publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Ndryshime në SNK 28 (i publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (i publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).

Përveç nëse nuk është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në pasqyrat financiare të shoqërisë.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda shoqërisë kryhet në lidhje me rreziqet financiare, operacionale dhe ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, të normës së interesit dhe atë nga çmimet e tjera), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Ky shënim shpjegues paraqet informacion në lidhje me ekspozimin e shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme si dhe objektivat, politikat dhe proceset e saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe kapitalit të shoqërisë. Shpjegime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare dhe veçanërisht në shënimin 26.

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme të krijimit dhe mbikëqyrjes së kuadrit të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdimi)

Politikat e shoqërisë për menaxhimin e rrezikut janë ndërtuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballët shoqëria, për të vendosur kontrole dhe limite ndaj rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, përmes standardeve të trajnimit dhe të menaxhimit, synon të krijojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Grupit Cosmote ("Grupi") mbikëqyr se si drejtimi monitoron përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e Grupit dhe shoqërisë për menaxhimin e rrezikut dhe rishikon përshtatshmërinë e kuadrit të menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat përballët shoqëria.

Instrumentet kryesore financiare të shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare në arkë dhe bankë, kredi ndaj palëve të lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, të drejtat dhe detyrimet e tjera.

a) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku që njëra palë në një instrument financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Për shkak të vëllimit të madh dhe shumëllojshmërisë së bazës konsumatore të shoqërisë, përqendrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga abonentët janë të kufizuara. Provigjonet për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta caktohen në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet potenciale në arkëtimin e gjendjeve të llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria ka investime financiare të rendesishme të mbajtura deri në maturim që kanë të bëjnë me obligacione të emetuara nga OTE plc dhe OTE SA, shoqëri nën kontroll të përbashkët. Për të cilët, Shoqëria nuk ka identifikuar rrezik mos-arkëtueshmërisë.

b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria të ketë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare. Shoqëria ka ekspozim kundrejt kërkesave për burime monetare. Rreziku menaxhohet nga Departamenti i Thesarit të shoqërisë përmes monitorimit të parashikimeve mujore të flukseve të parasë. Megjithatë, shoqëria arrin të gjenerojë fluske të rëndësishme monetare nga aktivitetet operacionale saqë ajo është e mendimit që rreziku i likuiditetit të saj është i papërfillshëm.

c) Rreziku i Tregut

(i) Rreziku i normave të interesit

Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të ndryshimeve në normat bazë të interesit kundrejt pozicionit të saj financiar dhe flukseve të parasë. Për rrezikun e normave të interesit ndaj të cilit është e ekspozuar shoqëria, referojuni shënimit 24.

(ii) Rreziku i kurseve të këmbimit

Shoqëria ka disa instrumenta financiare të mbajtura në Euro, si për shembull obligacione nga OTE plc, depozita në Euro me bankat dhe llogari të pagueshme afatshkurtra në Euro me furnitorët e aktiveve afatgjata më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, të cilat e ekspozojnë atë ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit. Drejtimi nuk ka investuar në instrumente mbrojtës për t'u mbrojtur ndaj këtij rreziku gjatë vitit 2017.

d) Analiza e ndjeshmërisë

Me anë të menaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe kurseve të këmbimit, shoqëria synon të reduktojë impaktin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e shoqërisë. Gjithsesi, në periudhën afatgjatë ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Efekti që mund të ketë një ndryshim në përqindjen e normave të interesit ose në vlerën e Lekut kundrejt monedhave të tjera më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, paraqitet në shënimin 24.

(e) Menaxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut, dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Bordi i

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdimi)

Drejtoreve monitoron kthimin ndaj kapitalin, të cilin shoqëria e përcakton si fitimi para tatimit pjesëtuar me kapitalin aksionar. Bordi i Drejtoreve monitoron gjithashtu edhe nivelin e dividendëve ndaj aksionarëve të zakonshëm.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme për nivelin e kapitalit.

Nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit në trajtimin e menaxhimit të rrezikut financiar dhe menaxhimit të kapitalit nga ana e shoqërisë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

7. Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit

	2017	2016
Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit:		
Të ardhura nga shërbimet me parapagim dhe kontratë	5,326,015	4,781,741
Të ardhura nga interkonjeksi	3,367,687	5,206,971
Të ardhura nga roaming	126,514	198,436
Të ardhura të tjera operative	168,916	220,734
	8,989,132	10,407,882
Të ardhura nga shitja e aparateve dhe aksesorëve	136,831	198,792
	9,125,963	10,606,674

8. Kosto e shërbimeve të realizuara

	2017	2016
Shpenzime interkonjeksi	2,922,589	2,710,940
Amortizimi	2,070,670	2,540,482
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (shënimi 11)	2,800,077	-
Riparime dhe mirëmbajtje	495,133	601,432
Tarifa "roaming" nga operatorë të rrjeteve ndërkombëtare	169,891	319,146
Shpenzime komunale	290,770	339,335
Shpenzime qiraje	224,252	209,707
Shpenzime personeli	196,311	185,239
Shpenzime për sigurinë e rrjetit	100,238	107,016
Linja të marra me qira	162,725	91,038
Shpenzime për kartat e parapaguara dhe kartave SIM	13,443	13,454
Të tjera	309,065	286,088
	9,755,164	7,403,877

Shpenzimet e interkoneksionit janë rritur si rrjedhojë e pagesës ndaj Plus në shumën 363 mln Lekë ndaj, për Tarifën e Terminimit të Thirrjeve.

9. Shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative

	2017	2016
Shpenzime reklamash	827,876	933,059
Shpenzime konsulence dhe tarifa të tjera	712,732	803,856
Shpenzime personeli	704,513	740,546
Komisione Distributoreve	605,709	455,596
Amortizimi	438,328	136,992
Shpenzime qiraje	146,234	131,861
Shpenzime komunale	61,699	63,334
Riparime dhe mirëmbajtje	20,992	30,861
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	10,398	11,795
Shpenzime të tjera administrative	165,802	126,337
	3,694,283	3,434,237

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

10. Shpenzime tatim fitimi**a) Komponentët e shpenzimit të tatim fitimit**

Provigjoni për tatim fitimin është analizuar si vijon:

	2017	2016
Tatim fitimi i vitit aktual	-	68,104
Tatim fitimi i shtyrë	550,641	65,658
	550,641	133,762

b) Rakordimi ndërmjet shpenzimeve tatimore dhe fitimit ose humbjes shumëzuar me normën e aplikueshme tatimore

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%). Rakordimi i shpenzimit për tatimin mbi fitimin me shumën e përcaktuar nga zbatimi i normës tatimore mbi fitimin në Shqipëri, është përmbledhur si në vijim:

	2017	2016
Fitimi para tatimit	(4,850,440)	155,826
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën ligjore të tatimit mbi fitimin	(727,566)	23,374
Shpenzime të pazbritshme dhe rregullime për të ardhurat e tatueshme	434,106	110,388
Humbja tatimore e panjohur e mbartur për vitet e ardhshme për vitin	293,460	-
Asetet e tjera të tatimeve të shtyra të panjohura	550,641	-
	550,641	133,762

c) Humbjet tatimore të mbartura

Shoqëria nuk ka njohur tatimin e shtyrë në lidhje me humbjen e papaguar të tatimit të mbartur prej 293,460 mijë lekësh (2016: zero). Humbja e taksave që mbartet në të ardhmen skadon pas 31 dhjetor 2020.

Shoqëria gjithashtu nuk ka njohur aktivet e tatimit të shtyrë në lidhje me diferencat e përkohshme të zbritshme prej 868,685 mijë lekësh (2016: zero).

d) Pozicioni i pasigurt i tatim fitimit

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por fitimet apo humbjet e deklaruarra për qëllime tatimore qëndrojnë provizore për aq kohë sa autoritet tatimore kontrollojnë deklaratat dhe regjistrimet kontabël të taksapaguesit dhe dorëzojnë një vlerësim final. Ligjislacioni dhe rregulloret/udhëzimet tatimore janë subjekt i interpretimeve nga autoritet tatimore.

Periudhat fiskale janë subjekt kontrolli nga autoritetet tatimore deri në pesë vite kalendarike që paraprijnë vitin për të cilin kryhet kontrolli. Në disa situata, kontrollet mund të mbulojnë periudha më të gjata kohore.

e) Tatim fitimi i arkëtueshëm

Lëvizjet në tatim fitimin e arkëtueshëm për vitet 2017 dhe 2016 paraqiten si në vijim:

	2017	2016
Çelje	799,691	864,779
Parapagime tatim fitimi	-	3,016
Kompensime	-	(68,104)
	799,691	799,691

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

10. Shpenzime tatim fitimi (vazhdim)

a) Tatimet e shtyra të analizuara sipas llojit të diferencës së përkohshme

Diferencat midis SNRF-ve dhe rregullave tatimore ligjore në Shqipëri krijojnë diferenca të përkohëshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Efekti tatimor i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme është detajuar më poshtë.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra u atribuohen elementëve të mëposhtëm:

	2017	2016
Aktive afatgjata materiale	1,112,746	690,793
Licensa	(244,050)	(173,119)
Kohë ajrore e shtyrë	25,625	65,284
Shpenzimet e përlogaritura të interkonjeksionit	(34,830)	(34,830)
Të tjera, neto	9,194	2,513
	868,685	550,641

Shkalla e aplikueshme e tatimit për llogaritjen e tatimeve të shtyra është 15%. Të gjitha lëvizjet në bilancet tatimore të shtyra njihen në fitim ose humbje.

	Në 1 Janar 2016	Njohja ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	Në 31 Dhjetor 2016	Mosnjohja në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	Në 31 Dhjetor 2017
Aktive afatgjata materiale	678,375	12,418	690,793	421,953	1,112,746
Licensa	(102,513)	(70,606)	(173,119)	(70,931)	(244,050)
Kohë ajrore e shtyrë	75,427	(10,143)	65,284	(39,659)	25,625
Interconnection	(34,830)	-	(34,830)	-	(34,830)
Te tjera	(160)	2,673	2,513	6,681	9,194
	616,299	(65,658)	550,641	318,044	868,685

Siç është përshkruar në Shënime 3 dhe më lart, Shoqëria nuk i ka njohur aktivet e tatimit të shtyrë në datën 31 dhjetor 2016 në bazë të rrethanave të tregut shqiptar të telekomunikacionit dhe ndikimin e tij në performancën e Shoqërisë dhe fitimet e tatueshme të pritshme të cilat konsiderohen të pamjaftueshme për tatime të shtyra të ardhura për t'u realizuar.

TELEKOM ALBANIA Sh.a.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumtat janë paraqitur në mijë Lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

11. Aktive afatgjata materiale

	Aktive administrative	Ndërtesa rrjeti	Sisteme dhe instalime telekomunikacioni	Mjete transporti me qera Financiare	Punime në proces	Total
Kosfo						
Gjendja më 1 janar 2016	3,010,269	8,140,642	33,961,736	-	1,114,564	46,227,211
Shtesa	86,024	120,200	1,044,712	15,366	388,487	1,654,789
Blerje nga palët e lidhura (shënimi 27)	2,948	-	-	-	-	2,948
Pakësime	(96,351)	-	(481,970)	-	-	(578,321)
Transferime nga aktivet në proces	8	38,222	351,734	-	(389,964)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,002,898	8,299,064	34,876,212	15,366	1,113,087	47,306,627
Gjendja më 1 janar 2017	3,002,898	8,299,064	34,876,212	15,366	1,113,087	47,306,627
Shtesa	48,204	59,687	487,933	-	521,634	1,117,458
Blerje nga palët e lidhura (shënimi 27)	-	-	-	-	-	-
Pakësime	(3,988)	(5,395)	(443,834)	-	-	(453,217)
Transferime nga aktivet në proces	1,311	30,022	322,131	-	(353,464)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,048,425	8,383,378	35,242,442	15,366	1,281,257	47,970,868
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2016	2,090,548	7,064,079	27,107,009	-	-	36,261,636
Shpenzimi i vitit	182,534	271,076	1,755,042	1,706	-	2,210,358
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 27)	3	-	-	-	-	3
Pakësime	(74,955)	-	(481,176)	-	-	(556,131)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,198,130	7,335,155	28,380,875	1,706	-	37,915,866
Gjendja më 1 janar 2017	2,198,130	7,335,155	28,380,875	1,706	-	37,915,866
Shpenzimi i vitit	165,025	236,758	1,643,009	5,116	-	2,049,908
Pakësime	(3,925)	(5,395)	(442,738)	-	-	(452,058)
Zhvleresime	271,754	487,044	2,041,279	-	-	2,800,077
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,630,984	8,053,562	31,622,425	6,822	-	42,313,793
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2016	804,768	963,909	6,495,337	13,660	1,113,087	9,390,761
Më 31 dhjetor 2017	417,441	329,816	3,620,017	8,544	1,281,257	5,657,075

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

11. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Zhvlerësime dhe rimarrje të mëvonshme

Shoqëria vlerëson në mënyrë të vazhdueshme përmirësimet teknologjike dhe progresin e aktiveve materiale duke rishikuar gjithashtu funksionet dhe përshtatshmërinë e tyre me infrastrukturën ekzistuese. Në rast se ndodhin dëmtime ose nxjerrje jashtë përdorimit, atëherë kryhet një testim zhvlerësimi dhe aktivi zhvlerësohet ose shitet.

Humbjet nga zhvlerësimi u njohën si rezultat i testit të zhvlerësimit i cili u krye nga menaxhmenti bazuar në rezultatet e analizës së vlerës në përdorim të Shoqërisë.

Duke marrë parasysh pozitën e parasë së gatshme të Telekom Shqipërisë prej 60,612 milionë Lekë, vlera e kapitalit neto është 66,801 milionë Lekë dhe vlera kontabël neto e Telekomit në shumën 74,346 milionë Lekë, që përfshinë emrin e mirë prej 2,750 milionë Lekë dhe pozicionin neto të parasë së gatshme të Telekom Albania. Vlera kontabël (kapitali neto) i Telekomit tejkalon vlerën e saj të drejtë minus kostot e nxjerrjes nga përdorimi prej 7.545 milionë lekësh. Shuma përfshin gjithashtu emrin e mirë (2,750 milionë lekë), i cili përfshihet në vlerën kontabël neto të Telekom Albania që krahasohet me vlerën më të ulët të shitjes për FV.

Ekspertët e pavarur të vlerësimit e konsiderojnë vlerën e drejtë të aseteve individuale në përputhje me SNRF 13. Provizionin njihet si rezultat i mos përdorimit në të ardhmen të pajisjeve ekzistuese UMTS, 3G dhe pjesërisht të rrjetit GSM si dhe aseteve të tjera që nuk lidhen me brezat e transmetimit.

Aktive në proces

Aktivët në proces lidhen kryesisht me pajisje, të cilat duhet të shpërndahen në stacione antenash të ndryshme në zbatim të planit të shoqërisë si dhe me punime në proces të cilat konsistojnë kryesisht në ndërtimin e ndërtesave ose stacioneve për antena. Më 31 dhjetor 2017 një pjesë e konsiderueshme e punimeve në proces përbëhet pajisje telekomunikacioni të përdorura.

Çështje të tjera

Asnjë prej aktiveve të shoqërisë nuk është përdorur si kolateral. Gjatë vitit aktual si dhe viteve të mëparshme, shoqëria nuk ka marrë hua për investime, si rrjedhojë, në koston e aktiveve afatgjata materiale nuk janë përfshirë interesa. Gjithashtu nuk ka aktive afatgjata materiale të blera me qira financiare.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

12. Aktivët afatgjatë jomateriale

	Liçenca 3G	Liçenca 4G/LTE	Liçenca	Programe kompjuterike	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2016	2,121,399	1,691,947	1,695,828	1,159,120	6,668,294
Shtesa	-	-	-	64,215	64,215
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 25)	-	-	-	12,190	12,190
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,121,399	1,691,947	1,695,828	1,235,525	6,744,699
Gjendja më 1 janar 2017	2,121,399	1,691,947	1,695,828	1,235,525	6,744,699
Shtesa	-	-	-	29,485	29,485
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 25)	-	-	-	11,566	11,566
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,121,399	1,691,947	1,695,828	1,276,576	6,785,750
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2016	602,547	85,297	195,339	983,322	1,866,505
Shpenzimi i vitit	141,434	112,802	125,586	87,281	467,103
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 25)	-	-	-	10	10
Gjendja më 31 dhjetor 2016	743,981	198,099	320,925	1,070,613	2,333,618
Gjendja më 1 janar 2017	743,981	198,099	320,925	1,070,613	2,333,618
Shpenzimi i vitit	141,434	112,802	116,671	84,978	455,885
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 25)	-	-	-	625	625
Zhvleresime	-	-	-	2,578	2,578
Gjendja më 31 dhjetor 2017	885,415	310,901	437,596	1,156,216	2,790,128
Vlera kontabël neto					
Më 31 Dhjetor 2016	1,377,418	1,493,848	1,374,903	164,912	4,411,081
Më 31 Dhjetor 2017	1,235,984	1,381,046	1,258,232	117,782	3,993,044

13. Inventari

	2017	2016
Aparate dhe aksesore	221,933	249,076
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	130,956	136,543
Karta SIM	24,147	26,835
Provizione	(24,480)	(24,023)
	352,556	388,431

Përveç shumës së regjistruar si kosto e shitjes së aparateve dhe aksesoreve, aparatet dhe aksesoret të cilat i janë ofruar klientëve për mbajtje ose shitje janë regjistruar si shpenzim shpërndarje dhe shitjeje në pasqyrën e fitimit ose humbjes për periudhën dhe kosto e shitjes arrin shumën 140,361 mijë Lekë (2016: 143,735 mijë Lekë).

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

14. Llogaritë e arkëtueshme

	2017	2016
Afatgjata		
Operatorë ndërkombëtarë të interkonjeksionit	-	10,664
	-	10,664
Afatshkurtra		
Klientë për shërbimet e ofruara	1,110,311	1,109,862
Operatorët kombëtarë të interkonjeksionit	1,093,782	1,159,512
Operatorët ndërkombëtarë të rrjetit GSM për shërbimet Roaming	1,771,975	1,460,100
Operatorët ndërkombëtarë të interkonjeksionit	27,269	56,596
Llogari të arkëtueshme nga distributorët	74,644	136,647
Të tjera	75,143	8,972
	4,153,124	3,931,689
Minus: Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(1,806,023)	(1,816,587)
	2,347,101	2,115,102
	2,347,101	2,125,766

Llogaritë e arkëtueshme nga distributorët përfshijnë të drejta të arkëtueshme nga shitja e kartave dhe aksesoreve tek distributorët e shoqërisë.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të monedhës dhe humbjeve nga zhvlerësimi në lidhje me llogaritë e arkëtueshme ishte si më poshtë:

	2017	2016
Vendase	547,857	598,406
Vendet e tjera	1,799,244	1,527,360
